

A.A.nr.37/2011

Gjykata Supreme e Kosovës: Vjosa Nimani-Zylfiu, kryetare e kolegjit, më 9 janar 2011, mori këtë:

A K T V E N D I M

Mospajtimi i kopjes së aktgjykimit të A.A.nr. 37/2011, datë 6 janar 2011 me origjinalin korrigohet ashtu : në reshtin e dytë të pjesës së dytë të dispozitivit , në vend të fjalës *vendvotimet*, siç është shënuar në kopje të aktgjykimit , duhet të jetë *qendrat e votimit* .

A r s y e t i m i

Kopja e aktgjykimit të Gjykatës Supreme A.A 37/2011, datë 6 janar 2011, e cila i është dorëzuar palëve, nuk është në përputhje me origjinalin e atij aktgjykimi.

Në përputhje me nenin 60 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 165 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore , gabimet në emra dhe numra, si dhe gabimet të tjera në shkrim dhe llogaritje, mosplotësimin e formës dhe mospajtimin e kopjes me origjinalin, do t'i korrigojë kryetari i kolegjit në çdo kohë.


Kopja e origjinalit të aktgjykimit A.A 37/2011, datë 6 janar 2011 i bashkëngjitet këtij aktvendimi dhe zëvendëson kopjen e cila më parë i është dorëzuar palëve.

Me zbatimin e dispozitave të përmendura më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

A.A.nr.37/2011, datë 9 janar 2011

Kryetarja e kolegjit
Vjosa Nimani-Zylfiu



Republika e Kosovës
REPUBLIKA KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË
AKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Vjosa Nimani-Zylfiu, kryetare, Emine Kaçiku dhe Gyltene Sylejmani, anëtare, me pjesëmarrjen e procesmbajtësit Bujar Balaj, në çështjen e zgjedhjeve, përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Blerim Sallahu, kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa nr.442/2010 datë 31.12.2010, në seancën e mbajtur më 06. 1.2011, mori këtë

A K T G J Y K I M

MIRATOHET ankesa dhe ANULOHET vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa nr.442/2010, datë 31.12.2010.

ANULOHEN rezultatet dhe urdhërohet Komisioni Qendror Zgjedhor t'i përsërisë votimet në qendrat e votimit shi më poshtë: në shkollën fillore “Migjeni” – Ilirida, në shkollën fillore “Abdullah Shabani” – Ilirida, në shkollën fillore “Fazli Grajçevci” – Shipol, në shkollën fillore “Shaban Idrizi” – Zhabar, në shkollën fillore “Skënderbeu” – Vaganicë, në rrugën “Sami Frashëri” nr.57 në Lagjen e Boshnjakëve, në shkollën fillore “Aziz Sylejmani” – Kodra e Minatorëve, në shkollën fillore “Andon Zako Çajupi” – Qendër, në shkollën fillore “Bedri Gjinaj” – Sitnicë, në shkollën fillore “Hivzi Sylejmani” – Kçiç, në shkollën fillore “Bajram Curri” – Gushavc, në shkollën fillore “Bajram Curri” – Vidimriç, në shkollën fillore “Minatorët” – Rahovë, në shkollën fillore “Trepça” në shkollën fillore “Mehë Uka” – Bajgorë, në shkollën fillore “Jusuf Rexha” – Kushtovë, në Shkollën Bujqësore – Lagja e Romëve, në shkollën fillore “Bislim Hajdari” Kaçandoll, në shkollën fillore “Habib Jusufi” – Bare, në shkollën fillore “Rifat Vidishiqi” në Bare, në shkollën fillore “Elena Gjika” - Tuneli i Parë, në shkollën fillore “1 Maji” – Shupkovc, në shkollën fillore “Sefedin Smakaj” – Rashan, në shkollën fillore “Fazli Grajçevci” – Vërbnicë, në shkollën fillore “Trepça” – Melenicë.

A r s y e t i m i

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje i ka paraqitur ankesë brenda afatit ligjor Gjykatës Supreme kundër vendimit A. nr.442/2010 datë 23.12.2010 të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), me të cilin është refuzuar ankesa e saj si e pabazuar. Ankesën e ka paraqitur për shkak të cenimit të së drejtës themelore - të drejtës zgjedhore dhe pjesëmarrjes në zgjedhje, garantuar me nenin 45 par. 2 të



Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ka propozuar që Gjykata ta miratojë ankesën dhe ta anulojë vendimin e ankimuar.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës kompetencën e Gjykatës Supreme e parashikon me dispozitën e nenit 118.4, në të cilin thuhet se mund të apelohet vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, ndërsa “ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës pranohet në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa 5.000 Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore”.

PZAP, në përgjigjen ndaj ankesës, ka theksuar se vendimi i tij është i bazuar në ligj dhe ka përsëritur thëniet se mosfunksionimi i llambave nuk ka ndikuar në rezultatin final të zgjedhjeve.

Gjykata Supreme, pasi që i vlerësoi thëniet në ankesë, shkresat e kësaj çështjeje dhe përgjigjen ndaj ankesës, gjeti se ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje më datë 15.12.2010, ka ushtruar ankesë në PZAP, me të cilën ka pretenduar se më datë 12.12.2010, ditën e Zgjedhjeve të Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në vendvotimet si në vijim: në shkollën fillore “Migjeni” – Ilirida, në shkollën fillore “Abdullah Shabani” – Ilirida, në shkollën fillore “Fazli Grajçevci” – Shipol, në shkollën fillore “Shaban Idrizi” – Zhabar, në shkollën fillore “Skënderbeu” – Vaganicë, në rrugën “Sami Frashëri” nr.57 në Lagjen e Boshnjakëve, në shkollën fillore “Aziz Sylejmani” – Kodra e Minatorëve, në shkollën fillore “Andon Zako Çajupi” – Qendër, në shkollën fillore “Bedri Gjinaj” – Sitnicë, në shkollën fillore “Hivzi Sylejmani” – Kçiç, në shkollën fillore “Bajram Curri” – Gushavc, në shkollën fillore “Bajram Curri” – Vidimriç, në shkollën fillore “Minatorët” – Rahovë, në shkollën fillore “Trepça” në shkollën fillore “Mehë Uka” – Bajgorë, në shkollën fillore “Jusuf Rexha” – Kushtovë, në Shkollën Bujqësore – Lagja e Romëve, në shkollën fillore “Bislim Hajdari” Kaçandoll, në shkollën fillore “Habib Jusufi” – Bare, në shkollën fillore “Rifat Vidishiqi” në Bare, në shkollën fillore “Elena Gjika” - Tuneli i Parë, në shkollën fillore “1 Maji” – Shupkoc, në shkollën fillore “Sefedin Smakaj” – Rashan, në shkollën fillore “Fazli Grajçevci” – Vërbnicë, në shkollën fillore “Trepça” – Melenicë, nuk kanë funksionuar bateritë fluorescente dhe ngjyra e padukshme me të cilën mund të verifikohet nëse i njëjti person voton më shumë se një herë dhe me këto veprime është cenuar neni 11.1 i Rregullës Zgjedhore nr.9/2009.

Gjykata Supreme, duke e miratuar ankesën e ankueses në këtë çështje ka vendosur dy herë më parë me aktgjykimet A.A.nr.131/2010, datë 17.12.2010 dhe A.A. nr 136/2010, datë 29. 12.2010. Herën e parë ka gjetur se PZAP-i është kompetent për të vendosur përkitazi me ankesën e Vetëvendosjes dhe, duke u bazuar në autorizimet e parashikuara nga neni 65 i LKA, e ka detyruar PZAP-in që çështjen ta vendosë në mënyrë meritore, kurse herën e dytë e ka detyruar PZAP-in që të japë arsye se si ka ardhur deri te përfundimi se mosfunksionimi i llambave ultravijollce nuk ka ndikuar në rezultatet finale të votimit.



PZAP- i në vendimin e ankimuar nuk e mohon faktin se më 12 dhjetor 2010 , në ditën e Zgjedhjeve të Përgjithshme në Kosovë, në orët e para , një apo dy orë, në disa vendvotime në rajonin e Mitrovicës nuk kanë funksionuar llambat ultravjollcë. Përkundrazi, thotë se “faktet e njohura sipas ligjit nuk vërtetohen”, por mendon se këto parregullsi nuk kanë ndikuar në rezultatin final të zgjedhjeve. Megjithatë, në asnjë vendim nuk jep arsye se përse këto shkelje qenkan pa ndikim në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, ndërsa për Gjykatën, një konstatim i tillë i përsëritur nuk ishte bindës për ta refuzuar ankesën si të pazuar.

Me par. 2 të nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës garantohet se vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. Neni 3 i Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut parashikon se zgjedhjet duhen të jenë të lira, të mbahen në intervale të arsyeshme dhe duhet të mbahen me votim të fshehtë, sipas kushteve që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit në zgjedhjet e legjislativës.

Me nenin 11.1 të Rregullës Zgjedhore nr.11/2009 parashikohet që, para se votuesi të lejohet të hyjë në vendvotim, kontrolluesi i rreshtit do të kontrollojë nëse ka njollë të ngjyrës së padukshme në gishtërinjtë e tij dhe nëse votuesi në gishtërinjtë e të cilit ka këso njolle, nuk do të lejohet të votojë.

Këto standarde nuk janë përmbushur.

Meqenëse nuk është kontestuese se në ditën e Zgjedhjeve të Përgjithshme llambat ultravjollcë nuk kanë funksionuar dhe këto shkelje nuk janë evituar, Gjykata, me qëllim që të evitohen defektet të cilat i ka vënë në pah ankuesja po i ka konfirmuar edhe vet PZAP-i në përputhje me nenin 46 par 2 dhe 4 të LKA vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
A.A.nr.37/2010, datë 06.01. 2011

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Vjosa Nimani -Zylfiu



Republika e Kosovës  Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUDSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës AA. 37/11
Oznaka spisa:

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA-LICNO DOSTAVLANJE

PEAP - PRISHTINA

1. Pasi marrësi, I cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi I sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtesës, fqit, personit që punon po n'atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokusajo dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestenja da radi dostavljanja bude u odredjeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrace susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____
dana _____ u _____ cas.

Shkaku i refuzimit të marrjes _____

Razlog odbijanja prijmea _____

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

1. AKT GJYKIM TË 06.01.2011
2. AKT UÇNDIM TË 09.01.2011

Numri i shtojcave: _____
broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)
Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima) 09/01/2011

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primioaca ili lica koje je
pismeno primilo u zamenu)

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljava

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljava

(Të panevojshmeve bjeri vizë - nepotrebne precrtati)

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkaku pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavac, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.